



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:113243
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05737592

E.nr.825/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në lëndën përmbartimore të kreditorit J.K. nga Shtimja, të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimet e procedurës, më datë 27.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.825/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.825/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.1308/2021, të datës 23.12.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 06.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 789.30 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.825/23, më datë 27.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi